

## Vendim nr. 16, datë 21.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahimimi, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 21.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (Z) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **ZYRA NOTERIALE PESHKOPI, NOTERE DHE ARKIVISTE MAJLINDA JANGULLI**, përfaqësuar nga avokat Ahmet Jangulli, me autorizim.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1125, datë 08.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 4, 7, 17, 41, 42, 116, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja ushtron profesionin e noteres në mënyrë individuale në një zyrë noteriale, brenda Bashkisë së Dibrës, për të cilën ka marrë licencën. Ajo është kallëzuar penalisht nga një shtetase për disa akte noteriale të hartuara prej saj. Për këtë kallëzim, pas disa veprimeve verifikuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë (*Prokuroria e Dibrës*), me vendimin e datës 23.02.2023, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se për veprat penale të kallëzuara “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal (*KP*), ndjekja penale nuk mund të fillonte për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit në rrethanat kur dokumentet e pretenduara si të falsifikuara datonin në vitin 2012.

2. Në vijim, në datën 22.12.2023, disa shtetase, përfshirë edhe kallëzuesen e parë, kanë paraqitur kallëzim penal ndaj kërkueses për falsitetin e akteve noteriale të hartuara nga kërkuesja pas datës 28.03.2012, bazuar në një akt noterial të falsifikuar të kësaj date (deklaratë për heqjen dorë nga bashkëpronësia), akte këto të lëshuara edhe në emër të tyre dhe që kërkuesja nuk ua vinte në dispozicion. Për këtë kallëzim, në datën 05.01.2024, Prokuroria e Dibrës ka regjistruar procedimin penal nr. 2 të vitit 2024, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i *KP*-së, duke shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e kërkueses. Në kuadër të këtij procedimi, në datën 04.04.2024, Prokuroria e Dibrës ka sekuestruar në zyrën e kërkueses 2 akte noteriale, një prokurë të posaçme dhe një deklaratë për heqjen dorë nga bashkëpronësia.

3. Në datën 05.04.2024 kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesë, duke kundërshtuar vendimin e sekuestrimit të provave materiale të datës 25.03.2023, njoftuar me shkresën e datës 25.03.2024, si dhe duke kërkuar kthimin e dokumenteve të sekuestruara me procesverbalin e datës 04.04.2024. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë (*Gjykata Dibrë*), me vendimin nr. 113, datë 16.04.2024, ka vendosur për papranueshmërinë e kërkesës penale të kërkueses. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesja dhe çështja është regjistruar në gjykatën e apelit, ku është në pritje për t’u gjykuar.

4. Ndërkohë, në përfundim të hetimeve paraprahe, Prokuroria e Dibrës, me një kërkesë të datës 07.05.2024, ka kërkuar pushimin e procedimit penal dhe Gjykata Dibrë, me vendimin nr. 509, datë 12.06.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal të regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i *KP*-së, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim dhe çështja është regjistruar në gjykatën e apelit, ku edhe ajo është në pritje për t’u gjykuar.

5. Në vijim, në datën 19.06.2024, kërkuësja ka paraqitur një kërkesë të re, duke kërkuar sërish kthimin e dokumenteve të sekuestruara sipas procesverbalit të datës 04.04.2024. Gjykata Dibër, me vendimin nr. 183, datë 05.11.2024, ka vendosur për papranueshmërinë e kërkesës së kërkuësës, me arsyetimin se ajo është haptazi e pabazuar. Sipas asaj gjykate, me kërkesë të prokurorit, Gjykata Dibër ka vendosur pushimin e procedimit penal, por pa u shprehur për provat materiale të sekuestruara, ndërkohë që ky vendim është ankimuar dhe çështja ndodhet për gjykim përpara gjykatës së apelit, duke mos pasur kështu ende një vendim të formës së prerë. Mbi ankimin e kërkuësës, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 43 (30-2025-196), datë 20.01.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1125, datë 08.07.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësës, me arsyetimin se ai ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), duke konstatuar se edhe për pretendimet në rekurs, që janë parashtruar edhe në ankimin drejtuar gjykatës së apelit, kërkuësja ka marrë përgjigje të arsyetuar nga kjo e fundit, vendimin e së cilës Gjykata e Lartë e ka çmuar si të mirarsyetuar.

6. Në datën 10.11.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar në objektin e tij vendimin e Gjykatës së Lartë të dhënë në procesin e tretë gjyqësor (*shih supra paragrafin 5 të këtij vendimi*).

## II

### Pretendimet e kërkuësës

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës së aksesit në aspektin substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e zakonshme janë shprehur për papranueshmërinë e kërkesës, duke mos e shqyrtuar atë në themel. Gjykata e apelit, duke mos zhvilluar seancë publike, i ka mohuar kërkuësës të drejtën e aksesit në gjykatë. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk i ka referuar të plota shkaqet e rekursit dhe, rrjedhimisht, nuk ka arsyetuar për to, duke i munguar kështu arsyetimi, qoftë edhe i kufizuar. Për rrjedhojë, kërkuësës i janë mohuar edhe një sërë të drejtash të tjera, si: *e drejta e moskufizimit të të drejtave dhe lirive*, e garantuar nga neni 17 i Kushtetutës; *parimin e barazisë përpara ligjit*, e garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së; *e drejta*

*për siguri juridike në proces dhe ajo ndaj pronës, të garantuara nga neni 41 i Kushtetutës; e drejta për punë, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës; e drejta për arsim e lidhur me mundësinë e ushtrimit të profesionit, për të cilin ka investuar, mundësia e përfuturit nga arsimi, e garantuar nga neni 57 i Kushtetutës dhe neni 2 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; e drejta e sigurisë juridike ndaj detyrës, duke krijuar në invers “norma të reja juridike”.*

- 7.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka konfirmuar qëndrimin se kërkesa për kthimin e sendit mund të paraqitet vetëm në fazën e ekzekutimit, pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.*
- 7.3. *Parimit të paanshmërisë në gjykim dhe së drejtës për një gjykim të drejtë, pasi gjykatat janë treguar të njëanshme në vendimmarrjet e tyre. Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, ka lënë në fuqi vendimet e paligjshme të gjykatave të faktit. Nga ana tjetër, i njëjti kolegji dhe i njëjti relator është shprehur në favor të kthimit të sendit në procese të tjera (vendimi nr. 00-2023-1533, datë 03.10.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Për më tepër, ky qëndrim është në kundërshtim me vendimin e saj njësuës nr. 23, datë 27.07.2021.*
- 7.4. *Së drejtës për t’u njoftuar, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesen për shqyrtimin e çështjes.*
- 7.5. *Së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi pretendimet e kërkueses mbi faktet dhe ligjin nuk janë referuar në vendimet gjyqësore. Gjatë procesit në gjykatën e shkallës së parë nuk janë marrë prova, pra ka munguar procesi kontradiktor, ndërsa procesi në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë duhet të ishte publik dhe jo në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve. Gjykimi është zhvilluar pa praninë e përfaqësuesit të akuzës.*

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor ose akti publik që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në

çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji çmon të theksojë se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Në këtë drejtim, mospërbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Kolegji konstaton se për sekuestrimin e 2 akteve noteriale të kërkueses janë zhvilluar paralelisht 3 procese gjyqësore. Procesi i parë është vënë në lëvizje nga kërkuësja, e cila ka kundërshtuar vendimin e sekuestrimit, duke kërkuar kthimin e dokumenteve të sekuestruara. Ky proces ka përfunduar në gjykatën e shkallës së parë, por gjykimi i tij nuk ka përfunduar ende në gjykatën e apelit, duke mos pasur kështu një vendim përfundimtar për kërkesën e kërkueses. Procesi i dytë është vënë në lëvizje nga Prokuroria e Dibrës, e cila ka kërkuar pushimin e procedimit penal, rast në të cilin gjykata ka detyrimin, sipas nenit 190 të KPP-së, të shprehet edhe për provat materiale të sekuestruara, detyrim i cili nuk është përmbushur nga gjykata e shkallës së parë, por megjithatë çështja vijon të jetë ende në gjykim përpara gjykatës së apelit, duke mos pasur edhe në këtë rast një vendim përfundimtar për fatin e dokumenteve, akteve noteriale të sekuestruara kërkueses. Procesi i tretë dhe i fundit është vënë në lëvizje sërish nga kërkuësja, e cila ka kërkuar përsëri kthimin e dokumenteve të sekuestruara. Ky proces, ndonëse është vënë i fundit në lëvizje, ka përfunduar në të tria shkallët e gjyqimit, por megjithatë kërkesa e kërkueses është gjetur e papranueshme në kushtet kur procesi i parë dhe i dytë vijonin ende.

11. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion subsidiar dhe përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga

sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprahe çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose të korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 42, datë 01.07.2025; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po kështu, Gjykata ka pranuar se vendimet e ndërmjetme të sekuestros, të dhëna gjatë hetimeve paraprahe, përjashtimisht i nënshtrohen kontrollit kushtetues, edhe pse gjykimi i themelit të fajësisë nuk ka përfunduar, duke u konsideruar ato si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, këto lloj vendimesh, ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale, ndaj konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 21, datë 22.04.2025; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, vendime të këtij lloji mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues vetëm nëse plotësohen disa kriteret që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj të drejtave kushtetuese të individit. Në këto raste, kërkuesi duhet të provojë se shkelja e pretenduar është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pra se ajo shkelje dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë procesit gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nisur nga sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimet e kundërshtuara të procesit të tretë gjyqësor nuk mund të konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllimet e kontrollit kushtetues, ndërsa ato, siç pranon edhe kërkuesja, nuk kanë vendosur për vendimin e sekuestrimit dhe fatin e dokumenteve të sekuestruara, të cilin ia kanë atribuar proceseve të tjera gjyqësore ose e kanë kushtëzuar atë me mënyrën e përfundimit të tyre. Po kështu, kërkuesja nuk ka parashtruar argumente që vendimet e kundërshtuara t'i kenë cenuar ndonjë të drejtë kushtetuese substanciale/materiale, në një mënyrë që të justifikojë shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pra se në rastin konkret ndodhet përpara një rasti përjashtimor nga kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive. Për më tepër, nuk evidentohet as ndonjë rrethanë e veçantë që ta bënte të domosdoshëm kontrollin e menjëhershëm kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se vendimet e kundërshtuara nuk e përmbushin këtë kriter, për sa kohë ekzistojnë ende mjete juridike të pashteruara që mund të sjellin korrigjimin e shkeljes së pretenduar.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.